Kronikë

Atentat për hakmarrje në Sarandë, 58-vjeçari vritet me tritol në makinë! Grup hetimor nga Tirana, para 3 muajsh tentuan t'i vrasin të birin (EMRI+VIDEO)

Isuf Jaçaj, 58-vjeç, sapo hipi në makinën e tij kur një sasi eksplozivi hodhi në erë mjetin e tij, duke e lënë të vdekur në vend. Report Tv mëson se tritoli është aktivizuar me telekomandë dhe ishte vendosur poshtë mjetit. Grupi hetimor, i nisur nga Tirana, pistën kryesore ka atë të hakmarrjes për shkak të konflikteve të të biri.

- U përdorën 800 gram eksploziv tritol! Shpërthimi i telekomanduar
- 58-vjeçari merrej me turizëm! Transportonte pushues me skafe
- Kush është Isuf Jaçaj! Të birit i hodhën mjetin në erë me tritol 3 muaj më parë dhe plagosja me armë në Sarandë
- Del FOTO, ja kush është viktima e atentatit me tritol në Sarandë

Redaksia
4 Tetor, 23:23 | **Përditesimi: 5 Tetor, 18:05**

Share

SARANDË- Një 58-vjeçar mbeti viktimë e një atentati të mirëorganizuar mbrëmjen e së shtunës në qytetin bregdetar të Sarandës. Një mjet u hodh në erë me tritol, ndërsa 58-vjeçari Isuf Jaçaj që ishte brenda në makinë humbi jetën menjëherë pas shpërthimit. Atentati është tipik mafioz, me 800 gram tritol të vendosur poshtë automjetit tip Toyota kur ai ishte i parkuar dhe në momentin kur viktima është futur në makinë autori e ka aktivizuar. Deri më tani policia ka shoqëruar 10 persona.

Ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 22:50 të 4 tetorit në lagjen numër 3, në të njëjtën lagje ku të birit të Isuf Jaçajt, Klaus Jaçajt vetëm 3 muaj më parë i hodhën në erë mjetin me tritol. Shpërthimi tronditi qytetin bregdetar, ndërsa Policia mbërriti menjëherë në vendin e ngjarjes dhe po punon për zbardhjen e saj.

Report Tv solli pamjet nga vendi i ngjarjes, ku dallohen dëmet e mëdha që janë shkaktuar në makinë nga shpërthimi i fuqishëm, ndërsa është dëmtuar edhe një tjetër mjet aty pranë, si edhe disa biznese. Hetuesit, një grup i nisur menjëherë nga kryeqyteti, dyshojnë se edhe vrasja e Isuj Jaçajt lidhet me ngjarjen e të birit, me pistën e hakmarrjes që mbetet për momentin kryesorja.

LEXO EDHE:
Vrasja e Isuf Jaçajt në Sarandë/ U përdorën 800 gram eksploziv tritol! Shpërthimi i telekomanduar

I biri i tij, Klaus Jaçaj, 31 vjeç, është përfshirë në një ngjarje kriminale më 17 korrik në qytetin e Sarandës dhe aktualisht ndodhet në burg. Vetë 58-vjeçari merrej me turizëm duke transportuar me skaf pushues drejt plazheve dhe duke bërë guida turistike.

> *"Rreth orës 22:50, në lagjen nr. 3, Sarandë, dyshohet se ka shpërthyer një sasi lënde eksplozive e vendosur në një automjet tip Toyota, në pronësi të shtetasit I. J. Ky shtetas dyshohet se është edhe personi që ndodhej brenda në automjet i cili si pasojë e shpërthimit ka humbur jetën", informoi Policia e Sarandës.*

Mjeti i cili u hodh në erë me tritol

Më 17 korrik, në qytetin e Sarandës dy të rinj ***u plagosën me armë zjarri*** nga Ramadan Zoto allias Canaj, 43 vjeç, pas një konflikti për një tokë në bregdet. Zoto qëlloi me armë dy të rinjtë nga Kamza, Gëzim Hajdarajn dhe Ernest Lamën. Ishte Klaus Jaçaj, ai i cili e ndihmoi Zoton të largohej nga vendi i ngjarjes, bashkë me të vëllanë Erjon Canaj, 36 vjeç. Klaus Jaçaj ***u arrestua*** vetëm 1 javë pas ngjarjes, ndërsa vetë Ramadon Zoto ***ra në pranga*** më datë 22 gusht në qytetin e Korçës.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Por vetëm 2 ditë para arrestimit, Klaus Jaçajt ***iu hodh mjeti në erë më tritol***. Makina ndodhej e parkuar po në lagjen numër 3, ku sot i vranë babanë, por 31-vjeçari nuk ishte në makinë. Shpërthimi me tritol i 22 korrikut në mjetin e Jaçajt mbeti një ngjarje e pazbardhur, ndërsa sot u hakmorën duke i vrarë babanë.

****Raportuan për Report Tv dhe Shqiptarja.com gazetarët, Limos Didani dhe Sokol Dema***

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:51

Vrasja e Isuf Jaçajt në Sarandë/ U përdorën 800 gram eksploziv tritol! Shpërthimi i telekomanduar

Në atentatin e mbrëmjes së djeshme, sipas ekspertëve të xhenios, dyshohet se janë përdorur rreth 800 gram eksploziv tritol, i cili ishte vendosur poshtë mjetit tip "Toyota" të Isuf Jaçaj.

Shpërthimi dyshohet të jetë kryer i telekomanduar.

Xh.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 10:58

Vrasja me tritol e Isuf Jaçajt, mbërrijnë nga Tirana ekspertët për të hetuar shpërthimin, dyshohet se është aktivizuar me telekomandë



Viktima e atentatit Isuf Jaçaj

Një grup ekspertësh, përfshirë edhe xhenierë, kanë mbërritur nga Tirana për të hetuar ngjarjen e shpërthimit me tritol të mbrëmjes së djeshme ku mbeti viktimë Isuf Jaçaj.

Sasia e eksplozivit ishte vendosur poshtë automjetit dhe dyshohet se është aktivizuar me telekomandë. Deri më tani, pista kryesore dyshohet të lidhet me djalin e tij, Kalus Jaçaj, i cili rezulton i përfshirë në një plagosje me armë zjarri më 17 korrik në Sarandë.

K.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:23

U vra në atentatin me tritol, 58-vjeçari merrej me turizëm! Transportonte pushues me skafe

58-vjeçari Isuf Jaçaj i cili u vra mbrëmjen e së shtunës në qytetin bregdetar të Sarandës, mësohet se merrej me turizëm. Ai transportonte pushues me skafe, ndërsa një vit më parë ishte pjesë e një proteste që pronarët e mjeteve ujore kishte organizuar para Bashkisë së Sarandës. Vetëm 3 muaj më parë, 58-vjeçarit kishin tentuar t'i vrasin të birin, i cili ishte përfshirë në një plagosje me armë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 00:04

U vra në atentat, kush është Isuf Jaçaj! Të birit i hodhën mjetin në erë me tritol 3 muaj më parë dhe plagosja me armë në Sarandë



Viktima Isuf Jaçaj

Isuf Jaçaj, 58 vjeç mbeti viktimë e një atentati me tritol mbrëmjen e së shtunës në Sarandë, pas një shpërthimi i të fuqishëm që tronditi qytetin bregdetar. Dyshohet se ai është vrarë për hakmarrje, pas një plagosje në të cilën u përfshi i biri më 17 korrik po në qytetin e Sarandës. Ai ndodhet në burg dhe akuzohet për përkrahje të autorëve të krimit, pasi ka ndihmuar dy autorët Ramadan dhe Erjon Canaj, të cilët qëlluan 2 të rinj pas sherrit për tokat në bregdet.

Ndërkohë, vetëm 3 muaj më parë, më 22 korrik, Klaus Jaçajt i hodhën në erë mjetin me tritol. Mjeti ishte i parkuar pranë një pallati, po në lagjen numër 3, në të njëjtën zonë ku babai i tij humbi sot jetën në një atentat me tritol.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 23:55

Del FOTO, ja kush është viktima e atentatit me tritol në Sarandë

Viktima Isuf Jaçaj

Report Tv ka siguruar foton e viktimës së atentatit me tritol në Sarandë. Viktimë ka mbetur Isuf Jaçaj, 58 vjeç. Ai ka humbur jetën pasi mjeti iu hodh në erë me tritol.



Viktima Isuf Jaçaj

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Isuf Jacaj | sarande | Vlore | shperthim me tritol | Klaus Jaçaj | Ramadan Zoto | Gëzim Hajdaraj | Ernest Lama | Erjon Canaj | vrasje | Vrasja e Isuf Jacajt

Komento

Komente

Liku: 05/10/2025 10:08

Shtet leshi. Ska as drejtesi as prokurori as polici asgje. Shumica e kane mendjen te kapin ndonje lek kudo me intriga. Lodhet njeriu per te drejten e tij sa ska vetem ketu. Vriten me bomba pastaj dhe si ben pershtypje me Njeriu. Ja prandaj ikin

Përgjigju

Ouuuu: 05/10/2025 07:35

Qe nga kamza keta dhe I ka lon gjyshi toke ke breeders I pru sali berisha nga Mali ne kamez hapen syte Ne 96 shkun ne sarand e polli gjyshi toke ne bregded.

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës: 4 Tetor, 20:56

PD pritet të mbështesë kandidatë të pavarur në 6 Bashki, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk kam mendim

Lajme të tjera





Berisha tha se do të mbështesin kandidatë të pavarur, PD e Vlorës del kundër: Emrin e zgjedhin forumet tona

4 Tetor, 20:37

Vlorë/ Zjarr i madh në Shën Andrea, forcat zjarrfikëse mbërrijnë në vendngjarje (VIDEO)

4 Tetor, 20:29

Sarandë/ Dyshohet se u dërgoi mesazheve 2 shoqeve të vajzës së tij, 50-vjeçari nën hetim për ngacmim seksual

4 Tetor, 12:40

Vetëplagosja e 36-vjeçarit në Vlorë, policia gjen pistoletën, ishte fshehur mes luleve (VIDEO)

4 Tetor, 11:56

U raportua i zhukur nga familjarët pasi shkoi të marrë pensionin, gjendet 93-vjeçari në Delvinë

4 Tetor, 09:22

Flamurtari luan sot në kryeqytet, vlonjatët projektojnë ndryshimin e trajnerit! Kontaktojnë ish-in e Vllaznisë

4 Tetor, 08:49

Revista 'Journée Mondiale': Zbuloni mrekullitë e Parkut Arkeologjik të Butrintit

4 Tetor, 08:42

Vlorë/ Banorët e 4 fshatrave kundër prishjeve të IKMT-së, mblidhen në 'Kuvendin Komunitar të Krahinës': Po na merren tokat për resorte

Armand Xhelili

3 Tetor, 21:45

Vritet me armë 65-vjeçari në Lezhë, u gjet i pajetë në brigjet e lumit Mat! Kishte 3 urdhra mbrojtjeje nga i biri (EMRI)

3 Tetor, 19:06

Nga 100 deri në 5000 lekë, miratohen tarifat, tuneli i Llogorasë bëhet me pagesë! Lista e mjeteve që përjashtohen nga pagesa

3 Tetor, 18:12



Shkencëtarja Aseda Tena rikthehet në Vlorë: Mjekët shpëtuan nënën time nga kanceri i gjirit! Po punoj për binjakëzimin e spitaleve shqiptare me ato amerikane

Armand Xhelili

3 Tetor, 17:13

Vlorë/ Shkoi në spital pasi vetëplagos me armë, arrestohet 36-vjeçari së bashku me shokun! Fshehën armën dhe nuk kallëzuan ngjarjen

3 Tetor, 14:57

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje